



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 16
11.10.2011

NR. VENDIMI 9
18.10.2011

VENDIM
“Ne emër te Republikës”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane e përbërë prej:

Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI

Asistuar nga sekretari gjyqësor **Besjan Hysi**, sot ne datën **18/10/2011**, ora **12.00 ne Tirane**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kerkesën penale nr. **16** që i perket :

Kërkues: Prokuroria pranë Gjykates së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, **perfaqësuar në gjykim nga prokurori A. Xh.**

Me objekt: Sekuestrimin e pasurive.

KUNDËR

A. K., i biri i A.-it dhe i H., i datëlindjes xx/xx/xxxx, lindur në xxxxxxxx dhe me banim në Lagjen nr.x, Rruga : “xxxxxx xxxxxx”, nr.xxx/x, shk.x, ap.xx/x, xxxxx, (*aktualisht rezulton se është i ekstraduar në SH.B.A.*)

PERSONA TE TRETË:

1. T. H. i biri i L. dhe A., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxxxx, Rruga «xxxxxx xxxxxxxx», pallati xx, shkalla x, ap.x, xxx xxxx e xxxxxxxx, Pallati nr.xx, xxxxx. (*person i lidhur me A. K.).*

2. A. K., i biri i B. dhe M., i datëlindjes xx/xx/xxxx, me banim në

lagjen nr.x, Rrugën : “xxxxx xxxx”, nr.xxx/x, shk.x, ap.xx/x, Tiranë, (*babai i A. K.*).

3. E. K., i biri i A.-it dhe i H., i datëlindjes xx/xx/xxxx, me banim në lagjen nr.x, Rrugën : “xxxxx xxxx”, nr.xxx/x, shk.x, ap.xx/x, Tiranë, (*vëllai i A. K.*).

4. O. K., e bija e K.-it dhe e L. , e datëlindjes xx/xx/xxxx, me banim në lagjen nr.x, Rrugën : “xxxxxx xxxxx”, nr.xxx/x, shk.x, ap.xx/x, xxxxxx, (*bashkëshortja e A. K.*).

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 10192 datë 03/12/2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës të zhvilluar në prani të prokurorit A. Xh. që kërkoi: pranimin e kërkesës, kjo gjykatë pasi dëgjoji kërkimet dhe shqyrtoi aktet e paraqitura :

VËREN se :

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka paraqitur para kësaj gjykate një kërkesë për sekuestrimin e pasurive të shtetasit A. K. dhe personave të tretë T. H., A. K. , E. K. dhe O. K. duke pretenduar se janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit **nr.10192 datë 03.12.2009** “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë” dhe **284/a** të Kodit Penal dhe pasuritë e zoteruara nuk i përgjigjen nivelit të të ardhurave dhe fitimeve të tyre, si dhe ekziston rreziku, që këto pasuri të humbasin, apo tjetërsohen. Kërkesën prokurori e paraqet duke ju këtyre fakteve:

“Më datë 08/07/2011, në Prokurorinë për Krime të Rënda, me shkresën nr. 14877 Prot, datë 07/07/2011, kanë ardhur aktet e dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut - Tiranë, me qëllim fillimin e procedurave për hetim pasuror ndaj shtetasit **A. A. K.**

Ky shtetas më datë 24/06/2011, është arrestuar në Pikën e Kalimit Kufitar

Rinas, pasi nga kontrollet e ushtruara prej punonjësve të policisë, në kabinat e hyrjes për në Republikën e Shqipërisë, ka rezultuar se është person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Washington, më datë 03/03/2011.

Shpallja e tij në kërkim është bërë pasi Gjykata e Teksasit me vendimin nr. 4:08CR177(12), datë 14/08/2008 ka lëshuar urdhër arresti, për veprën penale “Trafikim të lëndëve narkotike”, të llojit kokainë dhe “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”.

Mbi bazën e akteve të ardhura në mbështetje të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Grrimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë” në datë 11/07/2011, Prokuroria për Krime të Rënda, Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr. 13 në ngarkim të shtetasit A. K.

Nga hetimi pasuror janë identifikuar keto pasuri:

► Te regjistruara ne **ZQRPP Tiranë dhe ZVRPP Tiranë:**

1-Në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xx+x-xx/x, vol.x, faqe xx Tiranë, Rruga “xxxxx xxxxx”, pallati xxx/x, sh.x, k.x, ap.xx/x shtetasi **A. K. dhe H. K.**, kanë një pasuri Apartament me **sip.xx.xx mx, e regjistruar më datë 25/02/1998, e blerë në shumën 13.719 lekë.**

2-Në zonën kadastrale me nrxxxx, nr.pasurisë xxx/xx Tiranë, vol.x, faqe xxx, në fshatin Bërzhitë Tiranë, shtetasit **A. K. dhe T. H.**, kanë një pasuri të llojit “xxx” me **sip.xxxx mx, e regjistruar më datë 18/12/2007, e blerë në shumën 2.500.000 lekë.**

3-Në zonën kadastrale me nr.xxxxx, nr.pasurisë xxx/x Tiranë, vol.x, faqe xx, fshati Dobresh Tiranë, shtetasi A. K., **ka një pasuri të llojit “Pemtore” me sip.xxxxx mx, e regjistruar më datë 15/11/2006, e blerë në shumën 1.000.000 lekë.**

4-Kontratë shitblerje pasurie me nr.xxx rep dhe xx kol, datë **04/08/2001**, me anën e së cilës T. H. dhe A. K., **kanë blerë një sipërfaqe prej x.xxx mx tokë në fshatin Picar-Tiranë, me numër pasurie xxx/x, volumi x, faqe xx, për shumën prej 5.900.000 lekë**

5-Në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xx+x-x/x Tiranë, vol.xx, faqe xx, në Rrugën e Xxxxx Tiranë, shtetasit A. K. dhe T. H., **kanë një pasuri, të regjistruar më datë 31/05/2005.**

6-Në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xx - N4 Tiranë, vol.xx, faqe xxx, në Rrugën e Xxxxx Tiranë, shtetasit A. K. dhe T. H. , **kanë një pasuri të llojit “Njësi” me sipërfaqe xx x mx, të regjistruar më datë xx/xx/xxxx.**

7-Në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xx+x-x Tiranë, vol.xx, faqe xxx, në Rrugën e Xxxxx Tiranë, shkalla x, kati x, ap.x, shtetasit A. K. dhe T. H., **kanë një pasuri të llojit “Apartament” me sipërfaqe xx.x mx, të regjistruar më datë 25/04/2005, të blerë në shumën 1.900.000 lekë.**

8-Në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xxx+xx-xxx/x Tiranë, vol.xx, faqe xx, në Rrugën “xxxxxx e xxxx”, Xxxxxx xxxxx, shkalla xx, kati x, ap.xxx/x Tiranë, shtetasit A. K. dhe T. H., **kanë një pasuri të llojit “Apartament” me sipërfaqe xx.xx mx, të regjistruar më datë 05/10/2005.**

9-Në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xxx+xx-x Tiranë, vol.xx, faqe 43, në Rrugën “xxxxxx e xxxx” Tiranë, Xxxxxx xxxxx, shkalla xx, ap.x, shtetasit A. K. dhe T. H., **kanë një pasuri “”xxxxxx” me sipërfaqe xx.x mx, të regjistruar më datë 05/10/2005.**

10-Në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xxx+xx-xxx/x Tiranë, vol.xx, faqe xx, në Rrugën “xxxxx e xxxx” Tiranë, Xxxxxx xxxxx, shkalla xx, ap.xxx/x Tiranë, shtetasit A. K. dhe T. H. , **kanë një pasuri ”xxxxx” me sipërfaqe xx mx, të regjistruar më datë 10/06/2008.**

11-Sipas hartës Digitale të printuar më datë 25/07/2011, rezulton se në zonën kadastrale nr.xxxx, regjistri xxx, nr.rendor xxx, më datë **05/09/2000**, shtetasit A. K. dhe H. K. kanë blerë një apartament me sipërfaqe xxx.xx mx, x+x, në rrugën “xxxxxxx xxxxx”, pallati xxx/x, kati i xxxxx.

12-Sipas hartës Digitale të printuar më datë 25/07/2011, rezulton se në zonën kadastrale nr. regjistri xxx, nr.rendor xx, më datë **08/01/1999**, shtetasit A. K. etj, kanë blerë një pjesë x/x, nga trualli prej xx.x mx, në të cilën ndodhej njësia tregtare nr.xx/x, në shumën prej 1.500.000 lekë.

► **Nga pergjigjet e ardhura nga O.K.R, rezulton se:**

- A. K., figuron të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar si subjekt tregtar **person fizik pajisur me nipt xxxxxxxxx**. Aktualisht subjekti A. K. rezulton **me status të çrregjistruar**.
- A. K., figuron të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar si subjekt tregtar person fizik pajisur me vendim të Gjykatës Tiranë, nr. xxxxxx dt 29.7.2005, **i pa paisur me nipt**. Aktualisht subjekti A. K. rezulton me status të çrregjistruar.
- Figuron **te ketë qënë ortak në shoqerinë me pergjegjësi të kufizuar « xxxxx xxxx xxxxx »** i regjistruar në regjistrin tregtar si person juridik dt 21.2.2006, pajisur me nipt xxxxxxxxxxxx. Aktualisht subjekti « xxxx xxxx xxxxxx » **rezulton me status te çrregjistruar**. Me vendimin e ortakëve të dt. 01.10.2007, është **vendosur mbyllja dhe likuidimi i shoqerise « xxxxx xxxxx xxxxxxx » me nipt xxxxxxxxxxxx**.
- Figuron ortak **ME xx% TE KUOTAVE** ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar « xxxx xxxx xxxxxxxx » i regjistruar ne regjistrin tregtar **xx.xx.xxxxx, pajisur me nipt xxxxxxxxxxxx**. Aktualisht rezulton **me status aktiv**.
- **A. K.**, figuron te jetë i regjistruar në regjistrin tregtar si subjekt tregtar person fizik pajisur me vendim të Gjykatës Tiranë, nr 24152 dt

18.3.2003, i paisur me nipt xxxxxxxxxxxx.

- **A. K.** figuron te jetë i regjistruar në regjistrin tregtar si subjekt tregtar person fizik pajisur me vendim të Gjykatës Tiranë, nr 9924 dt 19.3.1999, i papaisur me nipt.

► Nga pergjigja e ardhur nga **Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr 14287/2 prot, dt. 27.7.2011 për shtetasit A. K. dhe A. K. , figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti privat.

Me shkresën nr 14287/1 prot dt 27.7.2011, nga tatimet rezulton se:

- NIPT xxxxxxxx x, është i regjistruar me administrator A. K.
- NIPT xxxxxxxxxxx x, është i regjistruar me administrator A. K..

► Me shkresën nr. 43296/1 prot, dt. 17.8.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë rezulton se :

- Shtetasi **A. K.** i dtl. xx.x.xxxx, figuron i regjistruar prane kesaj drejtorie, me status person fizik administrator (pronar) i subjektit A. K. me nipt xxxxxxxxxxxxxx x, me dt xx.x.xxxxx, me aktivitet xxxxxx.
- Më dt 27.3.2006 **ka kaluar subjekt i biznesit te madh.**
- Në vitin **2006** ka realizuar një qarkullim total ne vlere **x.xxx.xxx leke, ndersa per vitin 2007 dhe 2008, nuk ka deklaruar aktivitet,** si dhe ne muajin Qershor 2008 ka ndërprerë deklarimin, **ky subjekt nuk ka borxhe pranë sistemit tonë informatik.**
- Shtetasi A. K. është regjistruar në vitin 1999.

► Nga pergjigja e ardhur nga **Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Trasportit Rrugor Xxxxx** me nr 5067/1 prot. dt 17.8.2011, rezulton se;

- Shtetasi A. K., ka në pronësi automjetin me targë **xxxxxxxx**,
- Shtetasi A. K., ka në pronësi automjetin me targë **xxxxxxxx**.
- Shtetasi A. K., ka në pronësi automjetin me targë **xxxxxxxx**.
- Shtetasi E. K. ka në pronësi mjetin me targë **xxxxxxxx**.
- Shtetësja O. K. ka në pronësi mjetin me targë **xxxxxxxx**.

Lidhur ne automjetet e mësipërme, rezulton se:

-Mjeti me targë **xxxxxxxx**, në pronësi të shtetasit **A. K.** është i markës **BMW** , prodhim i vitit **xxxx**, me numër shasie **xxxxxxxxxxxxxx**, të cilën e ka blerë në dt **xx.x.xxxx** në shumën prej 500.000 lekë.

-Mjeti me targë **xxxxxx**, ne pronësi të shtetasit A. K. , është i markës Land Rover, prodhim i vitit **xxxx**, me nr. shasie **xxxxxx xxxxxxxxxxxxxx**, regjistruar në **datë 26.2.2008.**

-Mjeti me targë **18/08/2008**, në pronësi **te babait te A. (A.**

K.) është e markës Honda, prodhim i vitit xxxx, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxx, të cilën sipas kontratës me nr.xxxx Rep dhe xxxx kol, **datë 18/08/2008**, ja ka shitur djali i tij **A. K. 2008**. Këtë automjet, A. e ka sjellë nga xxxxxxxx.

-Mjeti me targë **XXXXXX**, ne pronësi te shtetasit **E. K.**, është e markës B.M.V, prodhim i vitit xxxxxx, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxx, të cilën e ka sjelle A. nga Amerika ne **dt xx.xx.xxxx**.

-Mjeti me targë **XXXXXX** është në pronësi te shtetases **O. K. bashkeshortja e A.**, e markes benz, prodhim i vitit xxxx, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxx, të cilën e ka **blerë ne vitin 2010, për shumën 6.000 euro**.

► Nga përgjigjet e ardhura nga bankat rezulton se shtetasi **A. K.** ka llogari rrjedhëse në:

- Bankën **Intesa Sanpaolo Bank** me numër xxxxxxxxxxxxxxxx. Kjo llogari është e hapur ne **dt 13.4.2006**. Aktualisht gjëndja ne këtë llogari është **349 euro**.
- Llogaria me numër xxxxxxxxxxxxxxxx është ne monedhën lekë, e hapur ne dt **xx.x.xxxx**. Aktualisht gjëndja ne këtë **llogari eshte 0 leke**, pasi kjo llogari është mbyllur në **dt 19.4. 2007**.
- Llogaria me numër , xxxxxxxxxxxxxxxx, është në monedhën dollarë, e hapur ne dt **xx.x.xxxx**. Aktualisht gjëndja ne këtë llogari **eshte 0 dollare, pasi kjo llogari figuron e mbyllur në dt 17.5.2011**

Ne Bankën Kombëtare Tregtare rezulton se shtetasi :

- **A. K.** është klient i kësaj banke, **ka llogari page** me numër xxxxxxxx, gjëndja ne këtë llogari është **0 lekë**.
- Shtetasi **A. ose H. Kore** ka nje llogari në këtë bankë me numër xxxxxxxx. Në këtë llogari në **dt 24 mars 2006** është bërë një derdhje në shumën 3.675.000 leke, të cilat janë terhequr në dt. 27 mars 2006. Ne dt. 27 mars 2008 ka nje derdhje në shumën prej 4.038.709 lekë shumë të cilën e ka tërhequr në dt 02 tetor 2008. **Gjëndja ne llogari eshte 0 leke**.
- Shtetasi **A. K. dhe P. B.** kane llogari bankare në këtë bankë me numër xxxxxxxxxxxx në monedhën lekë. Ne kete llogari janë depozituar dy shuma lekesh ne **dt 03.10.2006** shuma prej 4.300.000 leke dhe ne dt 06.10.2008 shuma 4.740.000 leke. **Gjëndja ne kete llogari eshte 0 leke**.

Shtetasi **E. K.** ka nje llogari rrjedhëse në bankën Raiffeisen. Shuma në këtë llogari **eshte 2 dollare**. Ne këtë llogari është kryer vetëm një trasfertë e shtetasit E. K. në favor të shtetasit D.V. në Amerikë me përshkrimin “pagesë per ilaçe”

- Ne Bankën ndërkombëtare tregtare shtetasi **E. K. ka bere nje trasfertë me jashtë.**

Në lidhje me pasuritë e identifikuara më sipër, prokurori pretendoi se duhet te bëjnë përjashtim nga procedura e sekuestros pasuritë e krijuara para vitit 2007, periudhë në të cilën ka filluar aktivitetin kriminal i shtetasit A. K. , sikundër janë:

1- Pasurisë së regjistruar në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xx+x-xx/x, vol.x, faqe xx Tiranë, Rruga “xxxxx xxxx”, pallati xxxxx/x, sh.x, k.x, ap.xx/x shtetasi **A. K. dhe H. K.**, kanë një pasuri Apartament me **sip.xx.xx mx, e regjistruar më datë 25/02/1998, e blerë në shumën 13.719 lekë.**

2- Pasurisë së regjistruar në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë xxx/x Tiranë, vol.x, faqe xx, fshati Dobresh xxxxx, shtetasi A. K. , **ka një pasuri të llojit “xxxxxxx” me sip.xxxxx mx, e regjistruar më datë 15/11/2006, e blerë në shumën 1.000.000 lekë.**

3- Pasurisë së regjistruar sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë me nr.xxx rep dhe xx kol, datë **04/08/2001**, me anën e së cilës T. H. dhe A. K., **kanë blerë një sipërfaqe prej x.xxx mx tokë në fshatin xxxx-Tirane, me numër pasurie xxx/x, volumi x, faqe xx, për shumën prej 5.900.000 lekë**

4 Pasurisë së regjistruar në zonën kadastrale me nr.xxxxx, nr.pasurisë x/xx+x-x/xx Xxxxx, vol.xx, faqe xx, në Rrugën e Xxxxx Xxxxx, shtetasit A. K. dhe T. H. , **kanë një pasuri, të regjistruar më datë 31/05/2005..**

5- Pasurisë së regjistruar në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xx+x-xxxx, vol.xx, faqe xxx, në Rrugën e xxxxx xxxxx, shkalla x, kati x, ap.x , shtetasit A. K. dhe T. H. , **kanë një pasuri të llojit “Apartament” me sipërfaqe xx.x mx, të regjistruar më datë 25/04/2005, të blerë në shumën 1.900.000 lekë.**

6- Pasurisë së regjistruar në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xxx+xx-xxx/x Xxxxx, vol.xx, faqe xx, në Rrugën “xxxxxx x xxxxx”, xxxxxx xxxxx, shkalla xx, kati x, ap.xxx/x Xxxxx, shtetasit A. K. dhe xxxxx xxxxx, **kanë një pasuri të llojit “Apartament” me sipërfaqe xx.xx mx, të regjistruar më datë 05/10/2005.**

7- Pasurisë së regjistruar në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xxx+xx-B xxxxx, vol.xx, faqe xx, në Rrugën “Xxxxxx x xxxxx” Xxxxx, Xxxxxx xxxxx, shkalla xx, ap.B, shtetasit A. K. dhe Xxxxx xxxxx, **kanë një pasuri “”Bodrum” me sipërfaqe xx.x mx, të regjistruar më datë 05/10/2005.**

8- Pasurisë së regjistruar sipas hartës Digitale të printuar më datë xx/xx/xxxx, rezulton se në zonën kadastrale nr.xxxx, regjistri xxx, nr.rendor xxx, më datë **05/09/2000**, shtetasit A. Kore dhe H. K. kanë blerë një xxxxxxx me sipërfaqe xxx.xx mx, x+x, në rrugën “xxxxxx xxxxx”, pallati xxxxx/x, kati i xxxx.

9 Pasurisë së regjistruar sipas hartës Digitale të printuar më datë 25/07/2011,

rezulton se në zonën kadastrale nr. regjistri xxx, nr.rendor xx, më datë **08/01/1999**, shtetasit A. Kore etj, kanë blerë një pjesë x/x, nga trualli prej xx.x mx, në të cilën ndodhet njësia tregtare nr.xx/x, në shumën prej 1.500.000 lekë.

Gjithashtu, përjashtim nga procedura e sekuestrimit duhet që të bëjnë dhe llogaritë bankare të mëposhtme;

- Llogaria me numër xxxxxxxxxxxxxxxx, në Banken **Intesa Sanpaolo Bank**.
Kjo llogari është e hapur në dt 13.4.2006. Aktualisht gjendja në këtë llogari **është xxxxx xxxx**.
- Llogaria me numër xxxxxxxxxxxxxxxx, në Banken **Intesa Sanpaolo Bank, e cila** është në monedhën leke, e hapur në dt. 13.4.2006.
Aktualisht gjendja në këtë **llogari eshte x leke**, kjo llogari **është e mbyllur ne dt 19.4. 2007**
- Llogaria me numër xxxxxxxxxxxx, në Banken **Intesa Sanpaolo Bank, e cila** është në monedhën xxxxx, e hapur në dt 13.4.2006. Aktualisht gjendja në këtë llogari **është 0 xxxxx pasi kjo llogari figuron e mbyllur ne dt 17.5.2011 .**
- Llogari page me numer xxxxxxxx, në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të shtetasit **A. K. ,** gjendja ne kete llogari **është x leke.**
- Llogaria me numer xxxxxxxx, në Bankën Kombëtare Tregtare, në emër të shtetasve **A. ose H. K. , e çelur** ne dt 24 mars 2006. **Gjendja në llogari është x leke.**
- Llogaria bankare me numër xxxxxxxx, në emër të shtetasve **A. K. dhe P. B. .** Kjo llogari është çelur në dt 03.10.2006. **Gjendja në ketë llogari është x leke.**
- Shtetasi **E. K.** ka nje llogari rrjedhëse në bankën Raiffeisen, me nr.**XXXXXXXXXX**. Shuma në ketë llogari **është 2 dollare.**

Po mbi pretendimet e prokurorit nga faktet e sipërpermendura te gjitha pasuritë e tjera duhet që t'i nënshtrohen procedurës së sekuestrimit, pasi janë të rregjistruara në emrin e shtetasit A. K. , në emër të shtetasit A. K. (babai i tij), E. K. (vëllai), O. K. (bashkëshortja), si dhe në emër të shtetasit T. H. (person i lidhur me A. K.). Ky fakt, si dhe fakti qe personat e lidhur me A. K. dhe familjarët e tij jane te lire, perbejne nje rrezik real dhe potencial që pasurite e mesiperme të tjetërsohen, apo te humbasin (neni 11/1, pikat “a”dhe “b”).

Po sipas prokurorit nga hetimet e deritanishme, rezulton se pasurite e mesiperme jane krijuar **pas muajit janar 2007**, ne te cilen eshte provuar fillimi i aktivitetit kriminal i shtetasit A. K. , arsye për të cilën kërkon që pasurite e paluajtshme të shtetasit A. K. , të familjarëve të tij si dhe të personave të lidhur me të, duhet qe t'i nënshtrohen procedurës së sekuestrimit, pasi ekzistojne të dhëna të mjaftueshme të bazuara në prova se keto pasuri janë

krijuar pas periudhes se përfshirjes së të hetuarve në veprimtari kriminale (neni 3/4 te ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009).

Prokurori pretendoi se i hetuari dhe familjaret e tij, nuk disponojnë të ardhura të ligjshme që të justifikojnë blerjen e këtyre pasurive te luajtshme dhe të paluajtshme, por keto pasuri janë krijuar si rezultat i aktivitetit te paligjshëm ne fushën e trafikimit te narkotikëve.

Gjykata vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesen e Prokurorisë për Krime të Rënda, e cila duhet të pranohet duke vendosur sekuestrimin e pasurive të shtetasit A. K. dhe personave te tretë xxxxx xxxxx, A. K. , E. K. dhe O. K. sepse:

Shtetasi shqiptar A. K. ndiqet penalisht nga organet amerikane të drejtësisë për veprat penale te “Trafikimit te lëndëve narkotike ” te llojit kokainë dhe “mbajtjes pa leje të armëve luftarake” te parashikuar nga nenet 21 dhe 18 të Kodit Penal Amerikan dhe 283/a dhe 278 të Kodit Penal Shqiptar.

Ky shtetas eshte arrestuar ne Aeroportin shqiptar Rinas ne datën 24/06/2011 në ekzekutim te masës së sigurimit “Arrest ne burg” të vendosur ndaj tij nga Gjykata e Teksasit me vendimin nr. 4:CR177(12), datë 14/08/2008 dhe shpalljes në kërkim pas këtij vendimi nga Interpol VVashington, fakte që provohen me aktet “procesverbal per arrestimin në flagrancë”, datë 24/06/2011, shkresa nr. 404kl/5 Prot, datë 15/06/2011 dërguar nga Ministria e Brendshme Shqiptare Prokurorisë së Pergjithshme dhe aktet shoqëruese te ardhura nga shteti amerikan.

Mbi bazën e këtyre akteve dhe urdhërit ndërkombëtar të kërkimit është dhënë vendimi nr. 782, date 26/06/2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, për miratimin e arrestit me qëllim ekstradimin e tij drejt ShBA-së.

Nga provat e paraqitura rezulton se ka indicje se personi ndaj të cilit kërkohet te sekuestrohet pasuria A. K. , ka qënë anëtar i një organizate droge që shpërndante sasi te mëdha kokaine .

Keshtu K. ishte një prej drejtuesve të organizates që lehtësonte marrjen e kokainës dhe drejtimin e të tjerëve për ta transportuar dhe shpërndarë atë duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me një burim furnizimi për marrjen e kokainës. Me 4 Maj 2008 A. K. kërkoi 3 kg kokainë nga një burim furnizimi. Kokaina iu trafikua në SHBA, nga Meksika dhe njëherë ne SHBA, u shpërnda ne Dallas, Teksas dhe Indiana. Për më tepër disa nga lëndët narkotike u dërguan në Shqipëri dhe Itali, duke u fshehur ne qirinj që dërgoheshin me barkë ne Europë ne kontenierë ngarkesash. Në total A. K. është përgjegjes për 20 deri ne 25 kg kokainë. Po ashtu ai ka zotëruar armë për ta ndihmuar në trafikimin e lëndëve narkotike.

Pra nisur nga lloji i veprës për të cilën hetohet “trafikimi i narkotikëve ” dhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar tek indicjet se shtetasi A. K. është i përfshirë në një veprimtari kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike të llojit kokainë, ai është subjekt ndaj pasurive të të cilit zbatohen dispozitat e ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”, sipas parashikimit **te nenit 3/1 pika ç** e këtij ligji.

Subjekte të këtij ligji janë dhe shtetasit T. H. (person i lidhur), A. K. (babai), E. K. (vellai) dhe O. K. (bashkeshortja), sipas kuptimit të nenit **3 /2 pikat a dhe b te ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009**.

Mbi këtë bazë, rezulton se akuza ka rregjistruar edhe procedimin pasuror nr. 13 në datën 11/07/2011, ndaj këtij shtetasi dhe pasi është kryer hetimi pasuror kjo çështje është paraqitur para kesaj gjykate me kërkesen për sekuestrimin e pasurive që janë verifikuar nga akuza se janë në pronesi të shtetasit A. K. dhe familjarëve apo personave të lidhur me të.

Ndonëse ligji nr.10192 ka datën 03/12/2009 dhe procedimi penal për shtetasin A. K. ka filluar, nga autoritetet gjyqësore të shtetit amerikan në vitin 2008, në bazë të nenit 3/4 të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009, ky ligj ka fuqi prapavepruese ndaj pasurisë së vënë nga shtetasi A. K. në periudhën e përfshirjes së tij në veprimtarinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike për të cilën dyshohet. Gjykata gjen të bazuar pretendimin e prokurorit se duhet të përjashtohen nga sekuestrimi pasuritë e evidentuara që janë krijuar para periudhës **muajit Janar 2007**, në të cilën është provuar fillimi i aktivitetit kriminal të shtetasit A. K. ,

Nga hetimi pasuror i kryer nga policia gjyqësore, sipas parashikimit të nenit 6 të ligjit nr.10192, akuza pretendon se si rrjedhojë e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, shtetasi A. K. ka fituar mjete financiare në mënyrë të paligjshme të cilat i ka investuar në formën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gjykata mbi bazën e provave të paraqitura, vlerëson së provohet se gjate periudhës që i dyshuari A. K. ka qënë i përfshirë në veprimtarinë kriminale në fushën e trafikimit të narkotikëve si dhe në periudhën e mëvonëshme, ka kryer investime në drejtim të pasurive të paluajtshme dhe investime të tjera, vlera e të cilave, haptazi nuk perputhet me veprimtarinë e ligjshme ekonomike të verifikuar nga akuza se ka kryer shtetasi A. K. në atë periudhë.

Pra në bazë të provave të paraqitura nga akuza, gjykata vlerëson se shtetasi **A. K.** është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009 “**Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë**” sepse jo vetëm që ka

dyshime të arsyeshme të bazuar në indicje se ai ka kryer një nga veprat penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr.10192, por edhe sepse i janë evidentuar nën posedim dhe në pronësinë e tij, familjarëve të tij dhe personave të lidhur me të pasuri dhe investime, të cilat nuk justifikohen dukshëm me veprimtarinë ekonomike të regjistruar të tyre.

Keshtu pasurite :

1- Pasurisë së llojit “ Are”, **me sip. xxxx mx**, me nr. xxxx, nr. pasurisë xxx/xx Xxxxx, vol.x, faqe xxx, **e blerë në shumën 2.500.000 lekë**, e cila ndodhet në fshatin Bërzhitë Tirane. Kjo pasuri është e regjistruar **më datë 18/12/2007** në emrin e shtetasve **A. K. dhe T. H. .**

2- Pasurisë së llojit “ Njësi” **me sipërfaqe xx x mx**, të regjistruar **më datë 21/06/2007**, në emër të shtetasve A. K. dhe T. H. . Kjo pasuri ndodhet në zonën kadastrale me nr.xx xx, nr.pasurisë x/xx - Nx xxxxx, vol.xx, faqe xxx, në Rrugën e xxxxx Tirane.

3- Pasurisë së llojit “ Bodrum”, **me sipërfaqe xx mx**, në pronësi të shtetasve A. K. dhe xxxxx xxxxx, **të regjistruar më datë 10/06/2008. kjo pasuri ndodhet në zonën kadastrale me nr. xxxx**, nr.pasurisë x/xxx+xx-xxx/x Xxxxx, vol.xx, faqe xx, në Rrugën “Xxxxxx x xxxxx” Xxxxx, Xxxxxx xxxxx, shkalla xx, ap.xxx/x Tirane.

4 Aktivitetit të shoqërisë aksionare “**xxxxx xxxxx xxxxxx**”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqëri në Shqipëri. Shoqëri e cila është regjistruar në xxx më datë 06/01/2010, me numër NIPTI xxxxxxxx, me datë themelimi 06/01/2010, me adresë xxxxx, Rruga “xxxxxxx e x”, pallati përballë fondacionit xxxx, me kapital fillestar 10.000.000 (dhjetë milion) lekë, me objekt; “Bar, restorant, kafene, piceri, hoteleri, turizëm, Import-eksport të të gjitha llojeve të mallrave ushqimore dhe industriale dhe të materialeve dhe makinerive të ndryshme në të gjithë sektorët e fushave të ndryshme. Veprimtari tregtare dhe financiare të pasurive të paluajtshme. Shitje me shumicë dhe pakicë, import-eksport të mallrave të ndryshme, materiale ndërtimi si pllaka etj.” Në këtë shoqëri, shtetasit A. K. dhe Xxxxx xxxxx, janë ortakë të saj, duke zotëruar sejcili nga **xx % (xxxxxxx përqind) të kapitalit, me nga xx (xxxxxxx) aksione sejcili në para. (Statusi aktiv).**

5- Mjetit tip xxx, me targë **xxxxxxx**, **prodhim i vitit xxxx**, me numër shasie **xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx**, në pronësi të shtetasit **A. K. ,** të cilën e ka blerë ne **dt xx.x.xxxx** ne shumën prej 500.000 leke.

6- Mjetit tip xxxxx xxxxx, prodhim i vitit xxxx, me targë **xxxxxxx**, me nr.shasie **xxxxxx xxxxxxxxxxxxxxxxxx**, në pronësi të shtetasit A. K., i regjistruar ne **datë 26.2.2008.**

7- Mjetit tip xxxxx, me targë **xxxxxxx**, prodhim i vitit xxxxx, me nr.shasie **xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx**, në pronësi **te babait te A. (A. K.)**, te cilen sipas kontratës me nr.xxxxxx Rep dhe xxxxx kol, **datë 18/08/2008**, ja ka shitur djali

i tij A. K. **xxxx**.

8-Mjetit tip xxx, me targë **XXXXXX**, prodhim i vitit 2001, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, në pronësi të shtetasit **E. K.**, te cilën e ka sjellë A. nga Amerika në **dt 05.11.2008**.

9-Mjetit tip Benz, me targë **XXXXXX**, prodhim i vitit 2008, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, në pronësi të shtetasit **O. K. (bashkeshortja e A. K.)**, te cilën e ka blerë në vitin **2010, për shumën 6.000 euro**.

Gjykata mbi bazën e provave të shqyrtuara vlerëson se ekziston një rrezik real për humbjen, apo tjetërsimin e këtyre pasurive dhe investimeve të pasqyruara me sipër, rrethanë, kjo e parashikuar nga neni **11/1** pika **a** e ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009**, prandaj me qëllim ruajtjen e saj, është e nevojshme vendosja e masës së sekuestrimit.

Meqenese sipas nenit 12 te ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009**, ky gjykim u zhvillua vetëm me prezencën e prokurorit, urdhërohet sekretaria gjyqësore të njoftojë zotëruesit e pasurive që sekuestrohen sipas neneve 130 e vijues të K.Pr.Civile, në vendbanimet e tyre.

Per ekzekutimin e ketij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** urdhërohet Zyra e Permbarimit Gjyqësor Tirane, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme (përkatësisht me numrat 1,2 dhe 3) ngarkohet **zgj. D. B.**, për administrimin dhe përdorimin e aktivitetit "**xxxxx xxxxx xxxxxx**" dhe pasurive te luajtshme (përkatësisht automjeteve) ngarkohet **z. A. H.**, te cilët jane administratorë pranë Agjencise per Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Mbi arsyetimin e pasqyruar më sipër në bazë të nenit 212 e vijues te K.Pr.Civile dhe neneve 3/1/d, 3/2/a, 3/4 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** "Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Njëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë", kjo gjykate pasi formoi bindjen dhe në mbeshtetje të provave të shqyrtuara në këtë gjykim:

V E N D O S I

Pranimin e kerkesës duke sekuestruar pasuritë e mëposhtme:

1. Pasuri e llojit "xxx", me sip.**xxxx mx**, me nr.**xxxx**, nr.pasurisë **xxx/xx** **Xxxxx**, vol.x, faqe **xxx**, e blerë në shumën **2.500.000 lekë**, e cila ndodhet në fshatin Bërzhitë **Xxxxx**. Kjo pasuri është e regjistruar më datë **18/12/2007** në emrin e shtetasve **A. K. dhe Xxxxx xxxxx**.
2. Pasuri e llojit "Njësi" me sipërfaqe **xx x mx**, të regjistruar më datë

21/06/2007, në emër të shtetasve A. K. dhe Xxxxx xxxxx. Kjo pasuri ndodhet në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xx - Nx xxxxx, vol.xx, faqe xxx, në Rrugën e xxxxx xxxxx.

3. Pasuri e llojit “ Bodrum”, **me sipërfaqe xx mx, në pronësi të shtetasve A. K. dhe Xxxxx xxxxx, të regjistruar më datë 10/06/2008. kjo pasuri ndodhet në zonën kadastrale me nr.xxxx, nr.pasurisë x/xxx+xx-xxx/x Xxxxx, vol.xx, faqe xx, në Rrugën “Xxxxxxx x xxxxx” Xxxxx, Xxxxxxx xxxxx, shkalla xx, ap.xxx/x Xxxxx.**
4. Aktiviteti i shoqërisë aksionare “**xxxx xxxx xxxxxx**”, kapitaleve, të gjitha të drejtave të kësaj shoqërie, si dhe të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që zotëron kjo shoqëri në Shqipëri. Shoqëri e cila është regjistruar në QKR më datë 06/01/2010, me numër NIPTI xxxxxxxxxxxxxx, me datë themelimi 06/01/2010, me adresë Xxxxx, Rruga “xxxxxxx e x”, pallati përballë fondacionit xxxx, me kapital fillestar 10.000.000 (dhjetë milion) lekë, me objekt; Bar, restorant, kafene, piceri, hoteleri, turizëm, Import-eksport të të gjitha llojeve të mallrave ushqimore dhe industriale dhe të materialeve dhe makinerive të ndryshme në të gjithë sektorët e fushave të ndryshme. Veprimtari tregtare dhe financiare të pasurive të paluajtshme. Shitje me shumicë dhe pakicë, import-eksport të mallrave të ndryshme, materiale ndërtimi si pllaka etj.” Në këtë shoqëri, shtetasit A. K. dhe T. H. , janë ortakë të saj, duke zotëruar secili nga **xx % (xxxxxxxxx përqind) të kapitalit, me nga xx (xxxxxxxxx) aksione secili në para. (Statusi aktiv).**
5. Mjet i tipit xxx, me targë xxxxxxxx, **prodhim i vitit xxxx, me numër shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx**, ne pronësi të shtetasit **A. K.**, te cilën e ka blere ne **dt xx.x.xxxx** ne shumen prej 500.000 leke.
6. Mjet i tipit Land Rover, prodhim i vitit xxxx, me targë xxxxxxxx, me nr.shasie xxxxx xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, ne pronësi të shtetasit A. K. , i regjistruar ne **datë 26.2.2008.**
7. Mjet i tipit Honda, me targë xxxxxxxx, prodhim i vitit xxxxx, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, ne pronësi **te babait te A. (A. K.)**, të cilën sipas kontratës me nr.xxxx Rep dhe xxxxx kol, **datë 18/08/2008**, ja ka shitur djali i tij A. K. **xxxx.**
8. Mjet i tipit xxx, me targë **XXXXXX**, prodhim i vitit xxxxx, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, ne pronësi të shtetasit **E. K.** , të cilën e ka sjellë A. nga A. në **dt 05.11.2008.**
9. Mjet i tipit Benz, me targë **XXXXXX**, prodhim i vitit xxxx, me nr.shasie **XXXXXXXXXXXXXXXXXX**, në pronësi të shtetasit **O. K. (bashkëshortja e A. K.)**, te cilën e ka blere ne **vitin 2010, për shumen 6.000 euro.**

Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme (përkatësisht

me numrat 1,2 dhe 3) ngarkohet **znj. D. B.** e cila është administratore pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbartimit Tirane.

Për administrimin dhe përdorimin e aktivitetit “**xxxxxxx xxxxxxx xxxxxxx**” dhe pasurive të luajtshme (përkatësisht automjeteve) ngarkohet **z. A. H.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbartimit Tirane.

Urdhërohet sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate të dergojë menjëherë kopje të këtij vendimi në institucionet e mësipërme si dhe për njoftimin e zotëruesve të pasurive A. K. , T. H., A. K. , E. K. dhe O. K. , në adresat e banimit të tyre.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda afatit ligjor.

U shpall sot në Tirane, më datë 18/10/2011, ora 13.00.

Sekretar
Besjan HYSI Ilir

Gjyqtare